

# SHKOLLA E MAGJISTRATURËS

Paraqet zhvillimin e një debati me temë:

“Regjistrimet Private (audio-video) në  
Procedimin Penal. Vlera e tyre dhe  
Mënyra e Përfshirjes në Fashikullin  
Hetimor”

- Shtetasi Elton Aliu është Drejtor pranë Ministrisë së Mjedisit.
- Është marrë i pandehur për kryerjen e veprave penale të “*Shpërdorimit të detyrës*” dhe “*Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike*”.

- Shtetasi Altin Altini është administrator i shoqërisë “Korabi”sh.p.k.
- Shoqëria “Korabi”shpk ka në pronësi të saj një fabrikë të prodhimit të çimentos.
- Ka aplikuar për marrjen e një leje mjedisore pranë Ministrisë së Mjedisit.
- Shoqëria “Korabi”sh.p.k prej 6 muajsh nuk ka marrë dot lejen mjedisore.

- Është regjistruar kryesisht nga Prokuroria procedimi penal në ngarkim të shtetasit Elton Aliu pas transmetimit publik në televizionin privat “Dajti” të 3(tre) bisedave.
- Bisedat janë regjistruar në mënyrë të fshehtë në audio dhe video.

# Transmetimi i parë në Televizionin “Dajti”

- Është kryer në zyrën e të pandehurit Elton, në Ministrinë e Mjedisit.
- Është regjistruar në mënyrë të fshehtë me celular nga administratori i shoqërisë “Korabi”shpk.
- I pandehuri përdor shprehje të tilla si: *“ti e di se si merret një leje mjedisi”, “pa miratimin tim asnjë leje mjedisi nuk jepet në ministri”, “unë dua pjesën time në këtë punë”*.
- Në Ministri kanë ardhur ankesa për ndotje të mjedisit nga fabrika e çimentos.

- Administratori i shoqërisë kontakton me gazetarët e televizionit “Dajti”.
- Televizioni “Dajti”sh.p.k merret me denoncimin e rasteve korruptive nga funksionarët shtetërore dhe publikë.
- Një gazetar do të prezantohej si avokat i shoqërisë “Korabi”sh.p.k
- Gazetari investigon edhe për ndotjet e mjedisit.

# Transmetimi i dytë në Televizionin “Dajti”

- Biseda zhvillohet midis të pandehurit Elton Aliu, administratorit të shoqërisë “Korabi”sh.p.k. dhe gazetarit të Televizionit “Dajti”.
- Regjistrimi është kryer në restorantin “Gjelbërimi”, pronë private e të pandehurit Elton Aliu.
- Regjistrimi, audio dhe video, është kryer nga gazetari i televizionit.
- Në këtë bisedë përsëritet i njëjti qëndrim korruptiv i të pandehurit.

# Transmetimi i tretë në Televizionin “Dajti”

- Biseda zhvillohet midis të pandehurit Elton Aliu dhe gazetarit të televizionit “Dajti”.
- Biseda, me kërkesë të gazetarit, është zhvilluar në shtëpinë e të pandehurit, me miratimin e tij.
- Është rënë dakord për një shumë të caktuar të hollash.



---

Prokuroria regjistron procedimin penal dhe merr si të pandehur shtetasin Elton Aliu.

Avokati mbrojtës paraqet një kërkesë/memo përpara Prokurorisë së Rrethit në bazë të neneve 105 dhe 110 të K.Pr.Penale:

1. Kërkon që regjistrimet private të mos merren si provë nga Prokuroria.
2. Kërkon që regjistrimet të mos përdoren sepse janë marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore për përgjimin, nenet 221 e vijues të K.Pr.Penale.

I pandehuri ka paraqitur kallëzim penal ndaj gazetarit të televizionit “Dajti”, për veprat penale:

- “*Ndërrhyrje e padrejtë në jetën private*” parashikuar nga neni 121 i K.P, për publikimin e të dhënave private, të regjistruara në shtëpinë e tij duke cënuar jetën e tij private.
- “*Korrupsioni aktiv i funksionarëve shtetërorë*”, të parashikuar nga neni 245 i K.P, sepse gazetari i kishte propozuar gjatë bisedës drejtpërsëdrejti përfitime të paligjshme.

- Gjate hetimit ka rezultuar se mund te jene kryer veprime te kundraligjshme te cilat përbejnë elementet e veprave penale në fushën e mjedisit.
- Akt-ekspertimi mjedisor paraqet shkelje të normave të emetimit të gazrave të dëmshme në atmosferë dhe përqindje të lartë të ndotjes së ujit.
- Rasti është paraqitur në Televizionin “Dajti”, në një emision ku denoncohen rastet e ndotjes së mjedisit.

# PYETJA E PARE PER DISKUTIM

- Cila është vlera provuese e regjistrimeve të fshehta të kryera nga administratori i shoqërisë dhe nga gazetari i televizionit?
- A do të konsiderohen si provë dhe a mund të përdoren gjate një procesi gjyqësor?
- Me çfarë cilësie do të administrohen këto regjistrime në procesin penal:
  - Përgjime (Neni 221 e vijues i K.Pr.Penale)
  - Prova dokumentare (Neni 191 i K.Pr.Penale)
  - Prova që nuk rregullohen me ligj (Neni 151 par.3 i K.Pr.Penale)
  - Prova materiale (Neni 187 i K.Pr.Penale)

# PYETJA E DYTË PËR DISKUTIM

1. A ekziston përgjegjësia penale e gazetarit për veprat penale:

- “*Ndërrhyrje e padrejtë në jetën private*”, parashikuar nga neni 121 i KP.
- “*Korrupsioni aktiv i funksionarëve shtetërorë*”, parashikuar nga neni 245 i KP.

2. A ka shkelje të së drejtës kushtetuese për një jetë private?

3. Kush është raporti midis të drejtës për jetë private dhe interesit publik?

# PYETJA E TRETË PËR DISKUTIM

- Cili do të jetë qëndrimi i Prokurorisë për veprat penale në fushën e mjedisit, në bazë të veprimeve hetimore të kryera?
- A ka cënim të së drejtës për informim të publikut në lidhje me ndotjet mjedisore nga ana e funksionarit publik?

- I pandehuri Elton Aliu ka paraqitur një memo/kërkesë, në të cilën ka pretenduar se kasetat dhe CD e regjistrimeve të mos administroheshin në fashikullin e hetimit pasi janë prova të paparashikuara në ligj dhe janë marrë në kundërshtim me dispozitat procedurale penale për përgjimin (nenet 221 e vijues të K.Pr.Penale).
- Në vlerësojmë se kemi të bëjmë me prova dokumentare, të rrjedhura nga regjistrime të kryera nga persona privatë.

- Regjistrimi i kryer nga persona private, përfshirë edhe një gazetar nuk është përgjim.
- Përgjimi sipas neneve 221 e vijues të K.Pr.Penale kryhet nga organet proceduese, prokuror dhe policia gjyqësore në bazë të një vendimi gjyqësor. Në raste urgjente përgjimi kryhet me urdhër të prokurorit.
- Nuk konsiderohet përgjim kur kemi regjistrim të bisedimeve nga njëra prej palëve pjesëmarrëse, qoftë dhe pa dijeninë e palës tjetër.
- Nuk ka shkelje të dispozitave procedurale mbi përgjimin, mbasi nuk jemi përpara një përgjimi sipas Kodit të Procedurës Penale.



- Jemi para llojit te provës “*dokument fonografik*”.
- Neni 191/1 te K.Pr.Penale parashikon: “*Lejohet marrja e dokumenteve, që përfaqësojnë fakte, persona ose sende, nëpërmjet fotografimit, filmimit, fonografimit ose çdo mjeti tjetër*”.
- *Kasetat dhe CD e regjistrimeve janë sekuestruar si prova materiale ne baze te nenit 208 te K.Pr.Penale.*
- *Transkriptimet e regjistrimeve, janë konsideruar si prova dokumentare fonografike qe shërbejnë për vërtetimin e fakteve objekt hetimi.*

- Nga ekspertimi audio dhe video të CD të regjistrimeve për identifikimin e zërit dhe të figurës, ka rezultuar se zëri dhe figura e paraqitur në këto regjistrime janë të të pandehurit.
- CD janë origjinale dhe nuk kanë ndërprerje, montime apo ndërhyrje.
- Regjistrimi nuk është kryer duke përdorur dhunë, ndikime të paligjshme ose duke e provokuar të pandehurin.

- I pandehuri, megjithëse në padijeni të regjistrimit , ka qenë i pandikuar në arritjen e synimeve dhe qëllimeve të tij.
- Gazetari ka pasur si qëllim të zbulojë fakte të paligjshme, me interes për publikun si shpërdorimi i detyrës nga një funksionar publik dhe ndotjet e mjedisit

- Regjistrimet fonografike janë prova të realizuara në mënyrë të ligjshme.
- Duhet të administrohen dhe të përdoren si prova nga organet e procedimit me cilësinë e provës dokument fonografik, neni 191/1 të K.Pr.Penale.
- Këto prova nuk kanë vlerë të paracaktuar dhe duhet të vlerësohen në unitet me provat e tjera të mbledhura gjatë hetimit/gjyqimit për vërtetimin e kryerjes së veprave penale.
- Vlera dhe fuqia e tyre provuese vlerësohen gjatë debatit dhe dhënies të vendimit gjyqësor

Ju faleminderit!